



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2024:100818  
Datë: 10.10.2024  
Numri i dokumentit: 06277903

C.nr.683/24

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Fëllenza Knushaj me bashkëpunëtoresh profesionale Gresa Haxhiavdyli, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditëses L. K. nga Gjakova, të cilën me autorizim e përfaqëson Fitim Gashi dhe Arben Biblekaj avokat në Prishtinë, Rr. "Fehmi Agani" Hy25/4 Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, vlera e kontestit 126.00 euro, jashtë seancës, më 10 tetor 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET e bazuar në ligj kërkesëpadia e paditëses L. K. nga Gjakova, dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses të lartcekur, t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 126.00 euro, dhe atë në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, për periudhën kohore nga data 25.06.2022, e deri me datën 21.11.2022, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të fillojë të llogaritet nga data 08.03.2024 (datë e parashtrimit të padisë) deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, në emër të shpenzimeve të procedurës, paditëses t'ia paguaj shumën prej 124.00 euro, në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësja, në këtë gjykatë me datë 08.03.2024, përmes të autorizuarit të saj, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, duke theksuar se paditësja është në marrëdhënie pune me të paditurën

dhe atë në shkollën “Selman Riza” në Gjakovë. Padi tëses nuk i është kompensuar nga e paditura obligimi për ushqimin në punë, andaj, ka kërkuar nga gjykata që për periudhën kohore prej datës 25.06.2022, e deri me datën 21.11.2022, në emër të shpenzimeve të ushqimit t’i paguhet shuma prej 126.00 euro e ka kërkuar kamatën ligjore si dhe shpenzimet procedurale.

E paditura Komuna e Gjakovës, përmes të autorizuarës së saj, në këtë gjykatë ka parashtruar përgjigje në padi me datë 04.10.2024, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar me arsyetimin se sipas kontratës së punës askund nuk është cekur se paditësit i takon kompensimi i shpenzimeve të ushqimit në punë, të cilën kontratë e ka nënshkruar paditësja dhe është pajtuar me kushtet, detyrat dhe obligimet që i ka. Ky kompensim nuk i takon as me Ligjin e Punës numër 03/L-212 i cili rregullon kontestet e punës e ku askund nuk e parasheh që punëtorëve të arsimit iu takojnë kompensimet e tilla, prandaj kërkesës së paditëses i mungon baza juridike. Kontrata Kolektive në të cilën është thirrur paditësja nuk ka fuqi ligjore sepse është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi. Kjo kontratë nuk është e nënshkruar nga Komuna e Gjakovës si autoritet i veçantë, respektivisht si njësi e vetëqeverisjes lokale si punëdhënës i vetëm i kësaj kategorie të punonjësve të arsimit. Sipas kontratave të punës parashihet për mësimdhënës që të i kenë 20 orë në javë si orë pune dhe 20 orë në javë si orë mësimi, ndërsa vërtetimet nuk qartësojnë çështjen e konkretizimit sa i përket ditëve të punës, duke theksuar se dita e plotë e punës është 8 orë pune dhe nuk mund të llogaritet si ditë pune e plotë koha prej 4 - 5 orëve punë aktive në shkollë. Po ashtu, sa i përket shujtave, duhet të ketë domosdoshmërisht dëshmi nga institucioni përkatës se nuk është e rregulluar forma e ushqimit brenda institucionit dhe që nuk paguhet ndonjë shtesë për shujtë nga punëdhënësi. Po ashtu, e njëjta është thirrur në parashkrim dhe në faktin se nuk janë shtjerrë të gjitha mjetet administrative dhe juridike sipas procedurës administrative të përcaktuar me nenin 78 par.1, 79 dhe 82 të Ligjit të Punës. Tutje ka theksuar se meqenëse Kontrata kolektive nga viti 2014 e tutje ka qenë në kundërshtim me ligjet e Republikës së Kosovës dhe si të tilla nuk prodhojnë asnjë efekt juridike gjë që vërtetohet me shkëputjen e njëanshme të kësaj kontrate nga MASHT-i me datë 21.11.2022, andaj e paditura e ka kundërshtuar padinë edhe në këtë drejtim për shkak të mungesës së bazës ligjore. Nga të lartcekurat, ka kërkuar nga gjykata që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, precizimit të padisë si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin

398 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënin e aktgjykimit jashtë seancës dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e themeltë dhe si e tillë u aprovua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigje në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontrata e punës për paditësen L. K., e lëshuar nga Komuna e Gjakovës, këtu e paditura, vërtetohet fakti se paditësja e lartcekur është në marrëdhënie pune tek e paditura si mësimdhënëse në shkollën “Selman Riza” në Gjakovë, dhe e njëjta ka punuar gjithsej 63 ditë pune (25.06.2022-21.11.2022), fakt i vërtetuar nga Vërtetimi me numër të protokollit 783/2023 për ditët e pranisë në punë i lëshuar nga drejtori i kësaj shkolle, i datës 31.10.2023. Gjukata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjukata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruara në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e vitit 2021. Duke u nisur nga fakti se e paditura, paditëses nuk ia ka paguar shpenzimet e ushqimit të parapara me nenin 35 par.7 të KKAK, ku është përcaktuar se: *“Të punësuarve iu njihet e drejta për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të ushqimit për një ditë të pranisë në punë, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie primare të punës në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restorantit apo kuzhinës, apo ndonjë forme tjetër nuk e ka obligim pagese (2 euro), të te punësuarve për ushqim për ta bërë kompensimin”*, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është në tërësi e themeltë, andaj në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit bëri përlllogaritjen në atë mënyrë ditët e pranisë në punë i ka shumëzuar me 2, duke ia njohur shumën prej 126.00 euro, të kërkuar si në petitum të padisë.

Gjukata vlerësoi pretendimin e të paditurës në lidhje me mungesën e bazës ligjore të kërkesëpadiës me arsyetimin se Ligji i Punës nuk e ka paraparë pagesën e kompensimit për shujta, mirëpo këtë pretendim e refuzoi për shkak se baza e kërkesëpadiës rrjedh nga Kontrata Kolektive e Arsimit, e cila në nenin 2 par.1 ka përcaktuar se *“Dispozitat e kësaj Kontrate*

*kolektive janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm, të ulët dhe të mesëm të lartë, shkolla speciale e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut.” Gjykata konsideron se kjo kontratë është marrëveshje e cila bazohet në Ligjin e Punës numër 03/L-212 ku ndër të tjera ky ligj në nenin 90 par.5, ka përcaktuar se “Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”. Andaj, për këtë arsye, gjykata konsideron se edhe pse Ligji i Punës specifikisht nuk e ka përcaktuar kompensimin për shujta, një gjë të tillë e ka paraparë Kontrata Kolektive e Arsimit, si marrëveshje kolektive në përputhje me Ligjin e Punës. Ndërsa, sa i përket pretendimit se e paditura nuk është nënshkruese e kësaj kontrate, një pretendim të tillë e refuzoi për arsye se Kontrata Kolektive e Arsimit është e nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, andaj prodhon efekt juridik ndaj punëdhënësve të cilët kanë të punësuar punëtorë që të drejtat e tyre burojnë nga kjo kontratë, në rastin konkret e paditura është punëdhënëse e paditëses dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga kjo kontratë për paditëses.*

Gjykata ka analizuar edhe pretendimin e të paditurës se nuk mund të llogaritet si ditë pune e plotë koha prej 4 – 5 orëve punë aktive në shkollë, mirëpo gjykata ditët e pranisë në punë i ka vërtetuar përmes vërtetimit të lëshuara nga shkolla përkatëse ku punon paditësja dhe të njëjtave iu fali besimin pasi që janë të hartuara në formën e caktuar nga organi përkatës brenda kufijve të kompetencës së tij.

Si pretendim tjetër të dhënë në përgjigje në padi, se në rastin në fjalë kemi parashkrim të kërkesës, gjykata një pretendim të tillë e refuzon si të pabazuar, për arsye se konform nenit 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, i njëjti ka përcaktuar se “*Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës*”, e që në rastin konkret paditësja ka kërkuar që t’i kompensohen shpenzimet e ushqimit për periudhën kohore prej datës 25.06.2022, e deri me datën 21.11.2022, ndërsa padinë e ka paraqitur me datë 08.03.2024, pra brenda afatit prej tre viteve nga kur ka lindur e drejta për kërkesën nga marrëdhënia e punës.

Gjykata ka analizuar edhe pretendimet e tjera të përfaqësuesit ligjor të të paditurës dhe atë në lidhje me faktin se nuk janë shtjerrë të gjitha mundësitë ligjore në procedurë administrative për

realizimin e kërkesës, mirëpo një pretendim të tillë e refuzojë pasi që gjykata nuk është e lidhur me mjetet administrative brenda institucionit përkatës kur vendos lidhur me kërkesën. Në rastin konkret, për të paditurën detyrimi për të iu kompensuar kompensimi në emër të ushqimit rrjedh nga Kontrata Kolektive e Arsimit dhe nuk duhet të jetë e lidhur me kërkesën e të punësuarës. Rrjedhimisht paditësja, si e punësuar në arsim, nuk ka qenë i detyruar që të bëjë kërkesë të veçantë për kompensim të shujtave, pasi të njëjtën punëdhënësi do të duhej ta përmbushte në momentin që janë plotësuar kushtet për kompensimin e tyre në përputhje me kontratën kolektive të lartcekur, prandaj meqë një detyrim i tillë nuk është përmbushur, ka lindur e drejta për të kërkuar kompensimin përmes rrugëve gjyqësore, siç ka vepruar në rastin konkret paditësja.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8%, i referohet nenit 382 të LMD-së dhe kamata është llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale si në pikën II të dispozitivit, u mor sipas nenit 449 dhe 452 par. 1 të LPK-së, me ç'rast paditëses iu pranua shuma e shpenzimeve në vlerë prej 124.00 euro. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara i referohet shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësore në vlerë prej 20.00 euro (e paraparë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore), për përpilimin e padisë shuma prej 104.00 euro (e paraparë sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës Nr. Tarifor 6 dhe 17).

Prandaj, gjykata bazuar në arsyet e cekura më lartë, bazuar në nenin 143 lidhur me nenin 398 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.683/24, më 10 tetor 2024

Gj y q t a r j a,  
Fëllenza Knushaj

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.